



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 13.39/prot.

Tiranë më 17.10.2017

Lënda: Opinion në lidhje me bërjen publike nga Kuvendi i Shqipërisë të dokumenteve që provojnë pëmbushjen e kriterëve ligjore nga kandidatët e përzgjedhur si anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë

KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Zyra e Komisionerit") u njoh me kërkesën tuaj, administruar me nr. 1339 prot, datë 11.10.2017 dhe me rrethanat e parashtruara në të.

Referuar dokumentacionit të kërkuar me shkresën nr. 2332 prot., datë 03.10.2017 nga organizata Lex Ferenda në kuadër të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "Ligji për të Drejtën e Informimit"), Zyra e Komisionerit vlerëson se pëmbushja e kriterëve ligjore nga ana e anëtarëve të Këshillave të Lartë Gjyqësor dhe atij të Prokurorisë është një nga faktorët elementarë për garantimin e profesionalizmit dhe integritetit të këtyre organeve, veprimtaria e të cilave do të garantojë zbatimin e reformës në drejtësi, si një proces me një impakt të ndjeshëm publik.

Sa i përket dokumentacionit të paraqitur nga secili anëtar me qëllim vërtetimin e pëmbushjes së kriterëve ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Zyra e Komisionerit, referuar dispozitave të cilat pasqyrojnë kriteret ligjore që kandidatët duhet të pëmbushin me qëllim zgjedhjen në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe atë të Prokurorisë (dhe përkatësisht nenet 7, 19, 36, 54, 105, 117, 134 dhe 152 të ligjit), si dhe duke marrë parasysh interesin publik që paraqet procesi i reformës në drejtësi dhe parimin e balancës midis të drejtës për informim dhe mbrojtjes së privatësisë, vlerëson se dokumentacioni i kërkuar nga organizata Lex Ferenda përbën informacion publik në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të Ligjit për të Drejtën e Informimit dhe si i tillë duhet të vihet në dispozicion të kërkuarit.

Siç mund të vërehet edhe në opinionet e mëparshme të dhëna për Avokatin të Popullit apo Kuvendin e Shqipërisë, Zyra e Komisionerit, që në fillim të procesit të përzgjedhjes së kandidatëve për organet e përfshira në procesin e zbatimit të reformës në drejtësi, i ka kushtuar rëndësi të veçantë transparencës në këtë proces, duke e vlerësuar si një qasje të domosdoshme nga secili institucion i përfshirë, me qëllim garantimin e një rezultati përfundimtar në përputhje me pritshmëritë e publikut nga kjo reformë.

Në këtë kuadër, vlerësojmë se kjo qasje duhet të adoptohet nga Kuvendi i Shqipërisë qoftë lidhur me kandidatët e përzgjedhur si anëtarë të institucioneve të përfshira në procesin e reformës në drejtësi, ashtu dhe me çdo informacion tjetër i cili në vlerësimin e institucionit përbën interes publik, duke e publikuar atë në mënyrë proaktive.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në dispozicion për çdo kërkesë të mëtejshme për mendim.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

